



Datë: 13.08.2025
Numër Protokolli: 5526/2025

A.nr.1139/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj–Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari- anëtarë, me Rushit Kajtazi- në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 1139/2025, të datës 13.06.2025, të parashtruar nga ankuesja A.A, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr. 1139/2025, e datës 13.06.2025, e parashtruar nga ankuesja A.A, ashtu që, anulohet njoftimi i datës 15.05.2025, për rezultatet përfundimtare dhe Njoftimi për verifikim paraprak i datës 11.04.2025 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr në fazën e verifikimit paraprak dhe në fazën e vlerësimit profesional, ndërsa, procedura e **pranimit kthehet në fazën e verifikimit paraprak**.

II. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, siç përcaktohet në pikën I të dispozitivit.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshme dhe Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, ashtu sikurse është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja A.A . (me tej referuar vetëm ankuesi), më datë 13.06.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr. 1139/2025, kundër zhvillimit të procedurës lidhur me Konkursi me numër referencës RN00016741, për “Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën ”Zyrtar për Regjistrimin Civil”, Civil” Drejtoria e Pajisjeve me Dokumente ARC- Ferizaj, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 2,

Drejtoria e Pajisjeve me dokumente Ferizaj me pretendime se i është bërë e pa të drejtë në fazën e procedurës së verifikimit paraprak.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 23.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Punëve të Brendshme ndërsa kjo e fundit, më datë 27.06.2025 ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A. Nr.1139/2025 të datës 13.06.2025; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursi me numër referencë RN00016741, i datës 14.02.2025; Njoftimin e datës 15.05.2025, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm; Kopje e letërnjoftimit për ankuesen; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 23.06.2025, dërguar nga R.K, për A.G; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 1139/2025, e datës 1139/2025; Vendimi me numër protokolli 552, i datës 04.04.2025; Vendimi me numër protokolli 536, i datës 01.04.2025; Lista e Aplikantëve; Njoftimi i datës 11.04.2025; Aplikacioni i A. A, me shkresat e bashkangjitura; Aplikacioni i H.K.Sh, me shkresat e bashkangjitura.

Duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, Kolegji i Këshillit ka gjetur se pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara në dispozitat ligjore, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 14.02.2025 ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00016741, për Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën ”Zyrtar për Regjistrimin Civil” Drejtoria e Pajisjeve me Dokumente ARC- Ferizaj, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 2 me afat aplikimi nga data 15.02.2025 deri me datë 16.03.2025.

Tutje, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 15.05.2025, me numër protokolli 923 ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatin fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja H. K-Sh, e cila është vlerësuar me gjithsejtë 93.8, pikë ndërsa ankuesja pretendon se nuk e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak.

Ankuesja A.A, e pakënaqur me procedurën e rekrutimit, me datë 13.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore të shënuar sikur në hyrje të këtij arsyetimi.

Në kuptim të dispozitave të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar konkursin me numër të referencës RN00016741, për Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën ”Zyrtar për Regjistrimin Civil” Drejtoria e Pajisjeve me Dokumente ARC, në Ferizaj, dhe për pasojë konstatoi se si kritere të përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë:

Arsimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Arsim i lartë i paspecifikuar;

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (1) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës

Nisur nga Konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit ka analizuar dosjen e kandidatës fituese znj, Hajrie Krasniqi -Shabani, dhe nga shkresat e lëndës konstaton së kandidatja e përzgjedhur posedon Diplomë me numër protokolli 587/1017, të datës 11.10.2017, të lëshuar nga Kolegji Fama, me çka dëshmohet se me datën 28.09.2017, ka përfunduar studimet Bachelor i Arteve në Shkencat Politike dhe Administratë Publike, si dhe diplomën e datës 20.07.2023, të lëshuar nga Universiteti i Evropës Juglindorë Tetovë, me çka dëshmohet së se ka përfunduar studimet Mastër në Lëmin e Administrimit Publik, ndërsa sa i përket përvojës së punës ka dorëzuar vërtetimi me numër protokolli 03-2308/17, të datës 06.09.2017, të lëshuar Posta e Kosovës me çka dëshmohet së nga data 03.08.2017, deri me datë 03.09.2017, ka mbajtur pozitën Praktikante, dhe sipas vendimit të datës 02.09.2024, të lëshuar nga Studenti SHOES SH.P.K, me çka dëshmohet së nga data 01.06.2023, deri me datën 31.08.2024, ka mbajtur pozitën praktikantë, si dhe në projektin e bankës botërore Këshilltare e Punësimit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve duke filluar nga data 11.11.2024 në afat një vjeçar. Kolegji ka marrë parasysh përvojën e punës së kandidatës H.K.SH (vetëm në MFPT, pasi që nuk ka nevojë ta mbështesë me dokumentacion përcjellës të Trustit apo ATK-së) deri në datën 11.04.2024 e krijimit të listës së ngushtë (procesin e verifikimit paraprak), prandaj bazuar në shkresat e lëndës të dërguar nga organi punëdhënës kandidatja që është shpallu fituese, nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për përfshirje në listën e ngushtë si dhe përzgjedhjen e saj, andaj nisur nga kjo rrethanë Kolegji me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke qenë së përfshija në listën e ngushtë e kandidatës H.K -Sh, dhe me tej si kandidatet fituese për pozitën "Zyrtar për Regjistrimin Civil" Drejtoria e Pajisjeve me Dokumente ARC- Ferizaj, i nxjerr nga Komisioni i Pranimi, është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, çdo veprim administrativ i ndërmarr nga Komisioni i Pranimi konsiderohet juridikisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si pasojë, Kolegji mbi bazën e këtyre të gjeturve edhe rrethanave vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloi Njoftimin e datës 15.05.2025, lidhur me shpalljen e kandidatit fitues dhe çdo veprim tjetër administrativ të ndërmarr në fazën e vlerësimit paraprak dhe fazën e vlerësimit profesional, duke e kthyer çështjen në fazën e verifikimit paraprak.

Përmbledhur si më sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 1139/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses A.A;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- dhe Arkivit të KPMSHCK-së